

Libër mësuësi

për tekstin shkollor

Matematika 3

Shtëpia botuese “Berati”

HYRJE

Libri i mësuesit/es për lëndën e Matematikës të klasës së tretë është punuar me qëllim që t'iu vihet në ndihmë të gjithë mësimeve që do ta përdorin këtë libër.

Ky libër përmban planprogramin vjetor, planprogramet mujore dhe ato ditore. Në planprogramin vjetor gjeni temat mësimore të shpërndara nëpër muaj si dhe kontributin e dhënë të temave për të arritur rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës. Planprogramet mujore janë të shpërndara në dy muajore (shtator-tetor, nëntor-dhjetor, janar-shkurt-mars dhe prill-maj-qershor) në të cilat janë të përfshira temat mësimore, rezultatet e të nxënësve për tema mësimore, njësitë mësimore, metodologjitë e mësimit, metodologjitë e vlerësimit, ndërlidhja me lëndët tjera mësimore si dhe burimet. Orët mësimore kanë rubrikat e specifikuar për aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore, përshkrimin e metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore.

Fusha/lënda e matematikës mbahet me nga 5 orë mësimore në javë, për 37 javë = 185 orë mësimore.

Fusha e matematikës ka si qëllim të pajisë nxënësit me modelet e të menduarit matematik, me idetë bazë për strukturat matematikore, si dhe t'iu zhvillojë aftësitë për llogaritje dhe zgjidhje të problemeve në jetën e përditshme. Nëpërmjet fushës së matematikës synohet zhvillimi intelektual, aftësimi për të gjykuar nga këndvështrime të ndryshme, si dhe zhvillimi i imagjinatës dhe aftësisë krijuese. Në klasën përgatitore dhe arsimin fillor fusha e matematikës promovon përvetësimin themelor të nocioneve dhe koncepteve matematike, kryerjen e veprimeve themelore matematikore, matje me instrumente jo standarde dhe standarde, formën e figurave dhe trupave gjeometrikë, grumbullimin e të dhënave, leximin dhe paraqitjen e grafikëve të thjeshtë, si dhe vendosjen e një baze të njohjes dhe qëndrimeve pozitive ndaj matematikës. Fusha e matematikës si qëllim ka zhvillimin e shkathtësive dhe aftësive të nxënësve për të menduar në mënyrë kritike, zhvillimin e personalitetit të tyre, zhvillimin e shkathtësive për të punuar në mënyrë të pavarur dhe sistematike, nxitjen dhe inkurajimin e ndërtimit të njohurive të reja me qëllim të zbatimit dhe integritit të tyre në fushat e tjera dhe zgjidhjen e situatave problemore në jetën e përditshme.

Shpresoj që ky libër të ju shërbejë në punën tuaj të përditshme!

Autorja

REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT KRYESORE TË SHKALLËS 2

FUSHA: MATEMATIKË
LËNDA: MATEMATIKË

I Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv

1. Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë.
2. Shkruan një tekst deri në një faqe (500 fjalë) e më shumë për një temë të caktuar.
3. Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.
4. Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërën nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj
5. Merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike në harmoni me moshën e vet, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.
6. Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo ndonjë ngjarjeje nga jeta, bën dallimin e tyre duke bërë një listë me vetitë që i pëlqejnë dhe që nuk i pëlqejnë tek ata, diskuton rreth tyre, performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarë.
7. Shpreh, në formë verbale dhe të shkruar, fjali të thjeshta në gjuhë të huaj dhe përkthen në gjuhë amtare fjali të tjera të thjeshta që i dëgjon nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësimdhënësi në gjuhë të huaj të dhëna si detyrë.
8. Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.

II Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

1. Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njëres nga format shprehëse.
2. Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera).
3. Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një mendim e qëndrim të shprehur apo sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
4. Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkenca e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme.
5. Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.

6. Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore - historike) në njërin nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.
7. Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyre të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore... etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minutash.
8. dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitive në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimet) të tyre.

III Kompetenca e të nxënës – Nxënës i suksesshëm

1. Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njëres nga format e shprehjes.
2. Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.
3. Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shënjuar me shenja të ndryshme).
4. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.
5. Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar.
6. Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korrigjimeve të nevojshme.
7. Identifikon cilësitë e veta që i posedon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.
8. Menaxhon sjelljet e veta, materialet/mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/ aktiviteti individual apo të përbashkët në klasë/shkollë apo jashtë saj.
9. Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

IV. Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis – Kontribues produktiv

1. Përgatit një autobiografi në të cilën prezanton veten me të dhënat personale dhe me prirjet për fusha të caktuara duke i gjetur të përbashkëtat me profesionet e dëshiruara.
2. Përgatit një plan pune për një javë dhe specifikon aktivitetet më me prioritet duke arsyetuar përzgjedhjen e tyre.
3. Përgatit një projekt të vogël duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupojnë atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.
4. Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes.

5. Debaton me moshatarë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë-laborator, në shkollë dhe në mjedise të tjera apo për një grup të caktuar njerëzish për një situatë të caktuar duke mbrojtur idetë e veta me shembuj konkretë.
6. Identifikon ushqimet më të shpeshta, materialet e tjera shpenzuese të familjes apo harxhimet vetjake dhe llogarit shpenzimet për një javë, të dhënat e gjetura i paraqet në formë tabelare/grafke apo në një formë tjetër.
7. Lexon etiketën, udhëzuesin e produkteve të ndryshme (rrobave, ushqimit, barnave apo të teknikës) dhe jep sqarim për prejardhjen, përmbajtjen, përdorimin, mënyrën e mirëmbajtjes apo për rreziqet në rast mospërdorimi të drejtë-adekuat.
8. Paraqet në formë tabelare, grafke, të vizatimit apo në një formë tjetër, aktivitetet e kujdesit që i bën ndonjë qenieje të gjallë, të cilat i mundësojnë zhvillimin, rritjen apo ruajtjen e shëndetit të tij/saj.

V Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

1. Prezanton para të tjerëve mënyrën e zbatimit të rregullave themelore të higjienës personale (fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit, ku jeton dhe vepron, përmes formave të ndryshme të shprehjes.
2. Merr pjesë në aktivitete fizike-lojëra lëvizore dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer, menaxhon emocionet e veta dhe prezanton para të tjerëve gjendjen fizike dhe shpirtërore pas realizimit të një aktiviteti fizik apo loje sportive.
3. Përgatit një listë (me njërën nga format e shprehjes, shkrim, vizatim etj.) me ushqime të cilat i konsumon familja duke i renditur ato sipas kalorisë dhe më pas i klasifikon në ushqime të shëndetshme dhe më pak të shëndetshme.
4. lexon të dhënat në paketim të ushqimit dhe diskuton në grup për këto të dhëna (vlerat ushqyese, afatet e prodhimit etj.).
5. Identifikon: përparësitë dhe mangësitë e personalitetit të vet dhe jep mendime për mënyrën e përmirësimit, në forma të ndryshme shprehëse.
6. Propozon alternativa për zgjidhjen konstruktive të një konfliktindërpersonal duke i analizuar paraprakisht me kujdes rrethanat që kanë shkaktuar konfliktin, ndan përvojat, mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit.
7. dallon dhe përshkruan rolet e personave dhe shërbimeve të nevojshme për kërkimin e ndihmës në situata të caktuara të rrezikut të shëndetit të vet, fizik dhe mendor.
8. Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).
9. Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtja e rregullt e sendeve që e rrethojnë etj.).

VI Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

1. Paraqet në forma të ndryshme të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të familjes së vet dhe i diskuton ato me të tjerët, më pas i krahason me të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve, mësuesve dhe staf menaxhues në shkollë apo me pjesëtarët e ndonjë institucioni.

2. Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.
- 3 Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh. besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti-mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret përshkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga ato.
4. Manifeston veprime që shprehin mirësjellje në situata të ndryshme dhe me shembull konkret tregon përdorimin e tyre në klasë/shkollë, në familje e në komunitet.
5. Propozon dhe ndan mendimin me shokët/shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësimor, të këshillave në klasë apo në shkollë, përbërjen dhe rolin e tyre.
6. Merr pjesë në hartimin e rregullave të lojës, në klasë, në shkollë (p.sh., si propozues rregullash, menaxhues i propozimeve nga të tjerët etj.) dhe argumenton rëndësinë e respektimit të ndonjërës rregull të propozuar në forma të ndryshme të shprehjes, duke parashikuar pasojat e moszbatimit të saj.
7. Identifikon dy e me shumë organizime shoqërore dhe përshkruan (në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër) mënyrat/mundësitë se si njerëzit e ndryshëm me përvoja të ndryshme mund të organizojnë diçka të përbashkët.
8. Prezanton në mënyrë kronologjike ndryshimet e familjes dhe të rrethit në aspekte të ndryshme (si: objektet e banimit, festat, veshjet, ushqimet-mënyra e të ushqyerit, menaxhimi i ekonomisë familjare, të drejtat, përgjegjësitë dhe vendimmarrja në familje etj.) ose disa nga personalitetet dhe ngjarjet kryesore të popullit të vet, duke e dalluar të tashmen nga e kaluara.
9. Paraqet me shembuj konkretë sjelljet që duhet manifestuar në rast rreziku nga fatkeqësitë natyrore apo të krijuara nga njeriu, si: zjarri, vërshimi, tërmeti, komunikimi me njerëz të panjohur etj.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS KURRIKULARE (RNF)

NJOHURITË, TË KUPTUARIT DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja përmes përvojave mësimore që ndërlidhen me:

1. Zgjidhjen e problemeve,
2. Arsyetimet dhe vërtetimet matematike,
3. Komunikimin në/përmes matematikë/s,
4. lidhjet matematike,
5. Përfaqësimin matematik,
6. Promovimin e modelimit matematik,
7. Strukturimin e të menduarit matematik.
8. Përdorimin e TIK-ut në/për matematikë.

1. Zgjidhja e problemeve:

- 1.1 Përshkruan kërkesat e problemeve të thjeshta;
- 1.2. Përdor mjete dhe metoda të thjeshta për matjen e formave 2d (d-dimensionale) dhe objekteve 3d;
- 1.3. Kryen veprimet themelore matematikore me numrat deri në shtatë shifrorë dhe kupton numrat e plotë negativë dhe thyesat.
- 1.4. Zhvillon, përzgjedh dhe zbaton strategjitë e zgjidhjes së problemave;
- 1.5. Bën vrojtime, hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike.

2. Arsyetimet dhe vërtetimet matematike:

- 2.1. Nxjerr rregullat, arsyeton konceptet dhe modelet e thjeshta matematikore, për të hapur rrugën për koncepte të reja;
- 2.2. Zhvillon dhe zbaton shprehi të arsyesimit si klasifikimi, dallimi i marrëdhënieve, përdorimi empirik i kundërshembullit;
- 2.3. Hamendëson dhe gjykon hamendësime;
- 2.4. Argumenton dhe mbron argumentin.

3. Komunikimi në/përmes matematikë/s

- 3.1. Përdor gjuhën natyrore dhe simbolet matematikore për të organizuar faktet, konceptet, idetë dhe veprimet themelore në matematikë; për të diskutuar me bashkëmoshatarët për rezultatet dhe sfdat e punës së tij;
- 3.2. Përforon strukturat mendore të ndërtuara më parë, të përshtatshme për matematikën duke parashtruar, pranuar dhe përgjigjur pyetjeve.
- 3.3. Përdor algoritmin e veprimeve me numra për të bërë njehsime me mend.
- 3.4. Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur: gjuhën e përditshme, fjalorin fllëstar matematik, paraqitje të ndryshme;
- 3.5. Komunikon të menduarin e tij matematik, duke përdorur simbole matematike;
- 3.6. Krijon paraqitje të koncepteve matematike me mjete konkrete, vizatime numra, simbole, tabela, diagrame;
- 3.7. Lidh konceptet mes tyre dhe i zbaton në zgjidhje problemash.

4. Lidhjet në matematikë

- 4.1. Bën lidhje mes njohurive paraprake dhe të reja për ndërtimin e koncepteve të reja në lidhje me numrat deri në shtatëshifrorë, të formave 2d dhe objekteve 3d.
- 4.2. Bën lidhje të njohurive dhe shprehive matematike me situata ose dukuri të marra nga jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj;
- 4.3. Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

5. Përfaqësimet matematike

- 5.1. Identifikon rregullat themelore për njehsimet me numra; kupton përdorimin e ndryshoreve për zgjidhjen e problemeve nga matematika dhe nga jeta e përditshme

6. Modelimi matematik

- 6.1. Përshkruan dhe krijon modele duke përdorur veprimet themelore matematikore në situata të përditshme (p.sh., ekonomisë familjare, statistika elementare për jetë etj.) që lidhen me numrat deri në gjashtëshifrorë, format 2d dhe objektet 3d;
- 6.2. Identifikon rregullat themelore për njehsimet me numra;
- 6.3. Kupton përdorimin e ndryshoreve për zgjidhjen e problemeve nga matematika dhe jeta e përditshme.

7. Strukturimi i të menduarit matematik

- 7.1. Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune; forcon strukturat mendore të ndërtuara më parë, relevante për matematikën duke parashtruar, duke pranuar dhe duke iu përgjigjur pyetjeve.

8. Përdorimi i TIK-ut në/për matematikë

8.1. Verifikon rezultatin e problemeve matematikore duke përdorur kalkulatorin për të provuar saktësinë;

8.2. Përdor kalkulatorin për gjetjen e rezultateve kur ka të bëjë me numra të mëdhenj.

PLANI VJETOR

Fusha e kurrikulës:	Matematikë		PLANI VJETOR		Lënda:	Matematikë
Lëndët e fushës kurrikulare	PERIUDHA I		PERIUDHA II		PERIUDHA III	Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës
	Shtator – Tetor 44 orë	Nëntor – Dhjetor 37 orë	Janar – Shkurt – Mars 58 orë		Prill – Maj – Qershor 46 orë	
Matematikë	Numrat deri 100 (14 orë) Bashkësitë dhe relacionet (7 orë) Numrat deri 1000 (11 orë) Drejtëzat (5 orë) Veprimet me numra deri në 1000 (7 orë)	Veprimet me numra deri në 1000 (10 orë) Matja e gjatësisë (6 orë) Vetitë e mbledhjes dhe zbritjes (8 orë) Matjet (4 orë) Barazimet dhe jobarazimet (8 orë) Këndet (1 orë)	Këndet (2 orë) Shumëzimi dhe pjesëtimi (11 orë) Paratë (2 orë) Shumëzimi dhe pjesëtimi (9 orë) Format gjeometrike (6 orë) Masa dhe matjet (3 orë) Mbledhja dhe zbritja me shkrim (13 orë) Sipërfaqet shumëkëndëshe (5 orë) Shumëzimi dhe pjesëtimi me shkrim (4 orë)	Format gjeometrike (4 orë) Shumëzimi dhe pjesëtimi me shkrim (7 orë) Puna me të dhëna (9 orë) Barazimet dhe jobarazimet (4 orë) Perimetri i shumëkëndëshit (5 orë) Thyesat (5 orë) Vargjet numerike (2 orë) Matjet (4 orë) Trupat gjeometrikë	Komunikues efektiv I.1, 3 Mendimtar kreativ II.1, 2, 3, 4, 5, 7, 8 Nxënës i suksesshëm III.1,2 ,3, 4, 5, 6, 7, 8 Kontribues produktiv IV.1, 2, 5 Individ i shëndoshë V.2,5 Qytetar i përgjegjshëm VI.6	

			Format gjeometrike (3 orë)	(6 orë)	
--	--	--	-------------------------------	---------	--

Plani dymujor – Shtator – Tetor

Fusha e kurrikulës: Matematikë

Lënda mësimore: Matematikë

Klasa: E tretë

Tema/t mësimore: Numrat deri 100, Bashkësitë dhe relacionet, Numrat deri 1000, Drejtëzat, Veprimet me numra deri në 1000, Matja e gjatësisë, Vetitë e mbledhjes dhe zbritjes, Matjet, Barazimet dhe jobarazimet, Këndet.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve: I.1, 3; II.1, 2, 3, 4, 5, 7, 8; III.1,2 ,3, 4, 5, 6, 7, 8;IV.1, 2, 5; V.2,5; VI.6

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë/mësimor)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p>Numrat deri 100</p> <p>Bashkësitë dhe relacionet</p> <p>Numrat deri 1000,</p> <p>Drejtëzat,</p> <p>Veprimet me numra deri në</p>	<p>-Lexon dhe shkruan numrat natyrorë deri në 100 dhe përcakton vlerën e çdo shifre.</p> <p>-Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave natyrorë deri në 1000.</p> <p>-Identifikon qindëshet dhe dhjetëshet e mijëshes së parë.</p> <p>-Përshkruan bashkësinë si grumbull elementesh duke dhënë shembuj nga jeta e përditshme.</p>	<p>1.Mbledhja dhe zbritja e numrave me kalim dhe prishje te 10</p> <p>2.Mbledhja dhe zbritja e numrave me dhjetëshe të plota</p> <p>3.Mbledhja e numrave dyshifrorë pa kalim të dhjetëshes</p> <p>4.Zbritja e numrave dyshifrorë pa prishje të dhjetëshes</p> <p>5.Mbledhja e numrave dyshifrorë me kalim të dhjetëshes</p> <p>6.Zbritja e numrave dyshifrorë duke</p>	44 orë	<p>Format sociale të aktivitetit me nxënës – individuale – në grupe</p> <p>Metodologjia e mësimdhënies me nxënësin në qendër (metodat e bashkëbisedimit, tekstuale, punimeve grafike dhe e demonstrimit.)</p> <p>Teknikat:</p>	<p>- vlerësimi i përgjigjeve me gojë;</p> <p>- vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë;</p> <p>- vlerësimi i ndihmesës gjatë punës në grup;</p> <p>- vlerësimi i detyrave të shtëpisë</p> <p>- testet për një</p>	<p>Gjuhën amtare - “përkthimi” i shprehjeve matematike nga gjuha e zakonshme në gjuhën matematike dhe anasjelltas;</p> <p>Artet e bukura - vizatimi i vijave të drejta të lakuara, të hapura, të mbyllura dhe figurave të ndryshme gjeometrike;</p>	<p>Matematika A</p> <p>Burime të tjera.</p>

1000, Matja e gjatësisë, Vetitë e mbledhjes dhe zbritjes, Matjet, Barazimet dhe jobarazimet, Këndet.	-Krahason bashkësitë sipas numrit të elementeve. -Identifikon elementet që i takojnë/ nuk i takojnë bashkësisë së dhënë. -Kryen matje të ndryshme duke përdorur njësitë standarde. -Krahason objekte të ndryshme bazuar në matjet e bëra. -Identifikon në shprehje të panjohurën dhe e gjen atë. -Dallon këndet dhe llojet e këndeve (kënd i drejtë, i ngushtë, i gjërë)	prishur dhjetëshen 7.Te gjejmë mbledhorin dhe zbritësin e panjohur 8. Te gjejmë mbledhorin dhe zbritësin e panjohur 9.Shumëzimi i numrave me 5 dhe me 10 10.Shumëzimi i numrave me 2 dhe 4 11.Shumëzimi i numrave me 3, 6 dhe 9 12.Pjesëtimi i numrave me 5 dhe me 10 13.Pjesëtimi i numrave 2, 4 dhe 8 14.Pjesëtimi i numrave me 3, 6 dhe 9 15.Bashkësitë – Kuptimi dhe elementet 16.Paraqitja e bashkësive me anën e kllapave 17.Ushtrime 18.Kuptimi i nënbashkësisë 19.Elementet e përbashkëta të bashkësive	Stuhi mendimesh DRTA Pesëvargëshi Ditari dypjesësh Kubimi Diagrami i Venit Bashkëbisedimi	grup temash të caktuara; - testet në fund të kategorisë së përmbajtjes; - testet në fund të gjysmëvjetorit; - testet në fund të vitit	Edukatën fizike dhe sportet - orientimi në hapësirë (lëvizjet majtas, djathtas, para, pas; kërcimet lartë, larg etj.; matjet e ndryshme; Punë dore - ndërtimi i figurave dhe i trupave të ndryshëm gjeometrikë nga kartoni, plastelina, argjila etj.	
---	---	--	---	--	---	--

		<p>20.Kuptimi i relacionit</p> <p>21.Ushtrime</p> <p>22.Njohuri për numrat deri në 1000</p> <p>23.Krahasimi i qindësheve të mijëshes së parë</p> <p>24.Ushtrime</p> <p>25.Qindëshet dhe dhjetëshet e mijëshes së parë</p> <p>26.Krahasimi i qindësheve dhe dhjetësheve të mijëshes së parë</p> <p>27.Ushtrime</p> <p>28.Leximi dhe shkrimi i numrave të mijëshes së parë</p> <p>29.Numrat treshifrorë</p> <p>30.Ushtrime</p> <p>31.Krahasimi i numrave treshifrorë</p> <p>32.Ushtrime</p> <p>33.Drejtëza, gjysmëdrejtëza dhe segmenti</p> <p>34.Prerja e dy drejtëzave, drejtëza nëpër dy pika</p> <p>35.Drejtëzat paralele</p> <p>36.Drejtëzat normale</p> <p>37.Ushtrime</p> <p>38.Mbledhja dhe zbritja e qindësheve</p>				
--	--	--	--	--	--	--

		39.Ndërrimi i vendeve të mbledhorëve 40.Vetia e shoqërimit të mbledhorëve 41.Ushtrime 42.Mbledhja e numrave treshifrorë me dhjetëshe të plotë 43.Zbritja e dhjetësheve të plota nga një numër treshifrorë 44.Mbledhja e numrave treshifrorë me një numër njëshifror					
--	--	--	--	--	--	--	--

Plani dymujor – Nëntor-Dhjetor

Fusha e kurrikulës: Matematikë

Lënda mësimore: Matematikë

Klasa: E tretë

Tema/t mësimore: Veprimet me numra deri në 1000, Matja e gjatësisë, Vetitë e mbledhjes dhe zbritjes, Matjet, Barazimet dhe jobarazimet, Këndet

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve: I.1, 3; II.1, 2, 3, 4, 5, 7, 8; III.1,2 ,3, 4, 5, 6, 7, 8;IV.1, 2, 5; V.2,5; VI.6

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë/mësimor)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p>Veprimet me numra deri në 1000 (10 orë)</p> <p>Matja e gjatësisë (6 orë)</p> <p>Vetitë e mbledhjes dhe zbritjes (8 orë)</p> <p>Matjet (4 orë)</p> <p>Barazimet dhe jobarazimet (8 orë)</p>	<p>-Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave natyrorë deri në 1000</p> <p>-Përdor metrin (m) dhe nënfishat e metrit si dhe kilometrin si njësi matëse të gjatësisë dhe kryen veprime me to.</p> <p>-Zbaton varshmërinë e shumës nga mbledhorët dhe pandryshueshmërinë e shumës.</p> <p>-Zbaton varshmërinë e ndryshimit nga i</p>	<p>1.Ushtrime</p> <p>2.Zbritja e numrave njëshifrorë nga një numër njëshifror</p> <p>3.Mbledhja e numrave treshifrorë me një numër dyshifror</p> <p>4.Zbritja e numrave dyshifrorë nga një numër treshifror</p> <p>5. Ushtrime</p> <p>6.Mbledhja e numrave treshifrorë</p> <p>7.Zbritja e numrave treshifrorë</p> <p>8.Mbledhja e numrave treshifrorë në shtyllë</p> <p>9.Zbritja e numrave treshifrorë në shtyllë</p> <p>10. Ushtrime</p> <p>11.Matja e gjatësisë</p>	37 orë	<p>Format sociale të aktivitetit me nxënës – individuale – në grupe</p> <p>Metodologjia e mësimdhënies me nxënësin në qendër (metodat e bashkëbisedimit, tekstuale, punimeve grafike dhe e demonstrimit.)</p> <p>Teknikat:</p> <p>Stuhimendimesh</p>	<p>- vlerësimi i përgjigjeve me gojë;</p> <p>- vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë;</p> <p>- vlerësimi i ndihmesës gjatë punës në grup;</p> <p>- vlerësimi i detyrave të shtëpisë</p> <p>- testet për një grup temash të</p>	<p>Gjuhën amtare - “përkthimi” i shprehjeve matematike nga gjuha e zakonshme në gjuhën matematike dhe anasjelltas;</p> <p>Artet e bukura - vizatimi i vijave të drejta të lakuara, të hapura, të mbyllura dhe figurave të ndryshme gjeometrike;</p>	<p>Matematika</p> <p>Burime të tjera.</p>

<p>Këndet (1 orë)</p>	<p>zbritshmi, zbritësi dhe pandryshueshmërinë e ndryshimit.</p> <p>-Gjen zgjidhjen apo bashkësinë e zgjidhjeve (lidhur me mbledhjen, zbritjen, shumëzimin dhe pjesëtimin) për ekuacionet apo inekuacionet e dhëna (numrat deri në 1000).</p> <p>-Dallon këndet dhe llojet e këndeve (kënd i drejtë, i ngushtë, i gjërë)</p>	<p>(metri, centimetri) 12.Matja e gjatësisë (Metri, decimetri, centimetri) 13. Ushtrime 14.Matja e gjatësisë (Metri, decimetri, centimetri, milimetri) 15.Matja e gjatësisë (Kilometri) 16.Ushtrime 17.Varshmëria e shumës nga mbledhorët 18.Varësia e shumës nga mbledhorët 19.Pandryshueshmëria e shumës 20.Ushtrime 21.Varshmëria e ndryshimit nga i zbritëshmi 22. Varshmëria e ndryshimit nga i zbritëshmi 23.Pandryshueshmëria e ndryshimit 24.Ushtrime 25.Matja e masës (Kilogrami, Dekagrami) 26. Matja e masës (Kilogrami, dekagrami, grammi) 27.Matja e masës (Tonelata, kilogrami)</p>		<p>DRTA</p> <p>Pesëvargëshi</p> <p>Ditari dypjesësh</p> <p>Kubimi</p> <p>Diagrami i Venit</p> <p>Bashkëbisedimi</p>	<p>caktuara;</p> <p>- testet në fund të kategorisë së përmbajtjes;</p> <p>- testet në fund të gjysmëvjetorit;</p> <p>- testet në fund të vitit</p>	<p>Edukatën fizike dhe sportet - orientimi në hapësirë (lëvizjet majtas, djathtas, para, pas; kërcimet lartë, larg etj.; matjet e ndryshme;</p> <p>Punë dore - ndërtimi i figurave dhe i trupave të ndryshëm gjeometrikë nga kartoni, plastelina, argjila etj.</p>	
---------------------------	---	---	--	---	--	--	--

		28. Ushtrime 29.Shprehjet me ndryshore 30.Gjejmë mbledhorin e panjohur X 31.Gjejmë mbledhorin e panjohur X 32. Ushtrime 33.Gjejmë të zbritshmin e panjohur X 34.Gjejmë zbritësin e panjohur X 35. Jobarazime lidhur me mbledhjen dhe zbritjen 36.Ushtrime 37.Kuptimi i këndit dhe elementet e tij					
--	--	--	--	--	--	--	--

Plani dymujor – Janar-Shkurt-Mars

Fusha e kurrikulës: Matematikë

Lënda mësimore: Matematikë

Klasa: E tretë

Tema/t mësimore: Këndet, Shumëzimi dhe pjesëtimi ,Paratë, Shumëzimi dhe pjesëtimi, Format gjeometrike, Masa dhe matjet, Mbledhja dhe zbritja me shkrim, Sipërfaqet shumëkëndëshe, Shumëzimi dhe pjesëtimi me shkrim, Format gjeometrike

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve: I.1, 3; II.1, 2, 3, 4, 5, 7, 8; III.1,2 ,3, 4, 5, 6, 7, 8;IV.1, 2, 5; V.2,5; VI.6

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë/mësimor)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p>Këndet (2 orë)</p> <p>Shumëzimi dhe pjesëtimi (11 orë)</p> <p>Paratëv (2 orë)</p> <p>Shumëzimi dhe pjesëtimi (9 orë)</p> <p>Format gjeometrike (6 orë)</p> <p>Masa dhe matjet</p>	<p>-Dallon këndet dhe llojet e këndeve.</p> <p>-Kryen shumëzimin e numrave njëshifrorë me numra njëshifrorë dhe dyshifrorë.</p> <p>-Njehson herësin ndërmjet numrave dyshifrorë dhe treshifrorë me numra njëshifrorë.</p> <p>-Përdor vetinë komutative dhe asociative për gjetjen e shumës, ndryshimit,</p>	<p>1.Llojet e këndeve</p> <p>2.Ushtrime</p> <p>3.Shumëzimi i numrave me 10 dhe 100</p> <p>4.Pjesëtimi i numrave me 10 dhe 100</p> <p>5.Shumëzimi i numrave me dhjetëshe dhe qindëshe të plota</p> <p>6.Ushtrime</p> <p>7.Pjesëtimi i numrave me dhjetëshe dhe qindëshe të plota</p> <p>8.Ndërrimi i vendeve të faktorëve</p> <p>9.Vetia e shoqërimit (Shoqërimi i faktorëve)</p>	58 orë	<p>Format sociale të aktivitetit me nxënës – individuale – në grupe</p> <p>Metodologjia e mësimdhënies me nxënësin në qendër (metodat e bashkëbisedimit, tekstuale, punimeve grafike dhe e demonstrimit.)</p> <p>Teknikat:</p>	<p>- vlerësimi i përgjigjeve me gojë;</p> <p>- vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë;</p> <p>- vlerësimi i ndihmesës gjatë punës në grup;</p> <p>- vlerësimi i detyrave të shtëpisë</p> <p>- testet për një</p>	<p>Gjuhën amtare - “përkthimi” i shprehjeve matematike nga gjuha e zakonshme në gjuhën matematike dhe anasjelltas;</p> <p>Artet e bukura - vizatimi i vijave të drejta të lakuara, të hapura, të mbyllura dhe figurave të ndryshme gjeometrike;</p>	<p>Matematika B</p> <p>Burime të tjera.</p>

<p>(3 orë)</p> <p>Mbledhja dhe zbritja me shkrim (13 orë)</p> <p>Sipërfaqet shumëkëndëshe (5 orë)</p> <p>Shumëzimi dhe pjesëtimi me shkrim (4 orë)</p> <p>Format gjeometrike (3 orë)</p>	<p>prodhimin dhe herësit të numrave.</p> <p>-Analizon varshmërinë e prodhimit nga faktorët.</p> <p>-Analizon varshmërinë e herësit nga i pjesëtueshmi dhe pjesëtuesi.</p> <p>-Mbledh dhe zbret paratë (euro deri në 1000).</p> <p>-Kryen veprimet me shprehje shkronjore.</p> <p>-Gjen vlerën e shprehjes shkronjore për vlera të caktuara të ndryshores.</p> <p>-Përdor litrin (l) si njësi për matjen e lëngjeve dhe kryen veprime me këtë njësi.</p> <p>-Emërton figurat gjeometrike, si: trekëndëshi,</p>	<p>10.Ushtrime 11.Shumëzimi i shumës dhe i ndryshimit 12.Pjesëtimi i shumës dhe i ndryshimit 13. Ushtrime 14.Monedhat 15.Ushtrime 16.Shumëzimi i numrave dyshifrorë me një numër njëshifror 17.Pjesëtimi i numrave dyshifrorë me numër njëshifror 18.Shumëzimi i numrave treshifror me një numër njëshifror 19. Ushtrime 20.Pjesëtimi i numrave treshifrorë me një numër njëshifror 21.Varësia e prodhimit nga faktorët 22.Varësia e herësit nga i pjesëtueshmi dhe pjesëtuesi 23.Pandryshueshmëria e prodhimit dhe e herësit 24. Ushtrime</p>		<p>Stuhimendimesh</p> <p>DRTA</p> <p>Pesëvargëshi</p> <p>Ditari dypjesësh</p> <p>Kubimi</p> <p>Diagrami i Venit</p> <p>Bashkëbisedimi</p>	<p>grup temash të caktuara;</p> <p>- testet në fund të kategorisë së përmbajtjes;</p> <p>- testet në fund të gjysmëvjetorit;</p> <p>- testet në fund të vitit</p>	<p>Edukatën fizike dhe sportet - orientimi në hapësirë (lëvizjet majtas, djathtas, para, pas; kërcimet lartë, larg etj.; matjet e ndryshme;</p> <p>Punë dore - ndërtimi i figurave dhe i trupave të ndryshëm gjeometrikë nga kartoni, plastelina, argjila etj.</p>	
--	---	--	--	---	---	--	--

	<p>drejtkëndëshi, katrori, rrethi etj.</p> <p>-Përkufizon shumëkëndëshin dhe tregon llojet e tij.</p> <p>-Ngjyros figurën simetrike dhe krijon figura simetrike.</p>	<p>25.Shumëkëndëshat 26.Trekëndëshat 27.Katërkëndëshat 28.Katërkëndëshat (drejtkëndëshi dhe katrori) 29.Pesëkëndëshi dhe gjashtëkëndëshi 30. Ushtrime 31.Matja e lëngjeve 32.Matja e lëngjeve (Litri, dekalitri, hektolitri dhe kilolitri) 33. Ushtrime 34.Mbledhja e numrave treshifrorë pa kalim të dhjetës 35.Zbritja e numrave treshifrorë pa prishje të dhjetës 36.Ushtrime 37.Mledhja e numrave treshifrorë me kalim të dhjetës 38.Zbritja e numrave treshifrorë me prishje të dhjetës 39. Ushtrime 40.Mbledhja e numrave treshifrorë me kalim të qindëseshes 41.Zbritja e numrave treshifrorë me prishje të qindëseshes</p>					
--	--	--	--	--	--	--	--

		<p>42. Ushtrime</p> <p>43.Mbledhja e numrave treshifrorë me kalim të dhjetëshes dhe qindëshes</p> <p>44.Zbritja e numrave treshifrorë me prishje të dhjetëshes dhe qindëshes</p> <p>45.Mbledhja e më shumë numrave treshifrorë</p> <p>46.Ushtrime</p> <p>47.Sipërfaqja trekëndëshe</p> <p>48.Sipërfaqja katërkëndëshe</p> <p>49.Sipërfaqja katërkëndëshe</p> <p>50.Sipërfaqjet pesëkëndëshe dhe gjashtëkëndëshe</p> <p>51.Ushtrime</p> <p>52.Shumëzimi i numrave me shkrim (Pa kalim)</p> <p>53.Shumëzimi i numrave me një kalim</p> <p>54.Shumëzimi i numrave me dy kalime</p> <p>55. Ushtrime</p> <p>56.Katrorët në rrjetin</p>				
--	--	---	--	--	--	--

		koordinativ 57.Pikat në rrjetin koordinativ 58.Zhvendosja paralele (Translacioni)					
--	--	---	--	--	--	--	--

Plani dymujor – Prill-Maj-Qershor

Fusha e kurrikulës: Matematikë

Lënda mësimore: Matematikë

Klasa: E tretë

Tema/t mësimore: Numrat deri 100, Bashkësitë dhe relacionet, Numrat deri 1000, Drejtëzat, Veprimet me numra deri në 1000, Matja e gjatësisë, Vetitë e mbledhjes dhe zbritjes, Matjet, Barazimet dhe jobarazimet, Këndet.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve: I.1, 3; II.1, 2, 3, 4, 5, 7, 8; III.1,2 ,3, 4, 5, 6, 7, 8;IV.1, 2, 5; V.2,5; VI.6

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë/mësimor)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p>Format gjeometrike (4 orë)</p> <p>Shumëzimi dhe pjesëtimi me shkrim (7 orë)</p> <p>Puna me të dhëna (9 orë)</p> <p>Barazimet dhe jobarazimet (4 orë)</p> <p>Perimetri i shumëkëndëshit</p>	<p>-Zbaton mbledhjen, zbritjen, shumëzimin dhe pjesëtimin në probleme.</p> <p>- Dallon thyesat që tregojnë të njëjtën pjesë të një tërësie.</p> <p>-Cakton pjesën e një tërësie.</p> <p>-Krahason thyesat me emërues/numërues të njëjtë.</p> <p>-Zgjidh problema nga jeta e përditshme duke përdorur</p>	<p>1. Ushtrime</p> <p>2.Zhvendosja paralele (Translacioni)</p> <p>3.Simetria ndaj drejtëzës</p> <p>4. Ushtrime</p> <p>5.Pjesëtimi i numrave me shkrim</p> <p>6.Pjesëtimi i numrave me shkrim (me zbrërthim të qindëshes)</p> <p>7.Pjesëtimi i numrave me shkrim (Me zbrërthim të dhjetëshes)</p> <p>8. Ushtrime</p> <p>9.Pjesëtimi i numrave me zbrërthim të qindëshes dhe</p>	46 orë	<p>Format sociale të aktivitetit me nxënës – individuale – në grupe</p> <p>Metodologjia e mësimdhënies me nxënësin në qendër (metodat e bashkëbisedimit, tekstuale, punimeve grafike dhe e demonstrimit.)</p> <p>Teknikat:</p>	<p>- vlerësimi i përgjigjeve me gojë;</p> <p>- vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë;</p> <p>- vlerësimi i ndihmesës gjatë punës në grup;</p> <p>- vlerësimi i detyrave të shtëpisë</p> <p>- testet për një</p>	<p>Gjuhën amtare - “përkthimi” i shprehjeve matematike nga gjuha e zakonshme në gjuhën matematike dhe anasjelltas;</p> <p>Artet e bukura - vizatimi i vijave të drejta të lakuara, të hapura, të mbyllura dhe figurave të ndryshme gjeometrike;</p>	<p>Matematika B</p> <p>Burime të tjera.</p>

(5 orë)	shprehjet shkronjore.	dhjetëshes 10.Pjesëtimi i numrave më mbetje		Stuhimendimesh	grup temash të caktuara;	
Thyesat (5 orë)	-Përcakton njësitë për matjen e kohës (dita, ora, minuta).	11.Ushtrime 12.Kuptimi i të dhënave		DRTA	- testet në fund të kategorisë së përmbajtjes;	Edukatën fizike dhe sportet - orientimi në hapësirë (lëvizjet
Vargjet numerike (2 orë)	-Vizaton trekëndëshin, drejtkëndëshin, katrorin dhe rrethin.	13.Leximi i të dhënave nga tabela 14.Plotësimi i tabelave me të dhëna		Ditari dypjesësh	- testet në fund të gjysmëvjetorit;	majtas, djathtas, para, pas; kërcimet lartë, larg etj.; matjet e ndryshme;
Matjet (4 orë)	-Cakton pozitën e dy drejtëzave-drejtëza paralele, drejtëza noramle dhe prerjen e drejtëzave.	15.Ushtrime 16.Plotësimi i tabelave me të dhëna		Kubimi	- testet në fund të vitit	Punë dore - ndërtimi i figurave dhe i trupave të ndryshëm gjeometrikë nga kartoni, plastelina, argjila etj.
Trupat gjeometrikë (6 orë)	-Cakton pozitën e dy drejtëzave. -Përcakton faqet, brinjët dhe kulmet e trupave gjeometrikë. -Zbulon të panjohurën në detyrat e dhëna. -Gjen zgjidhjen e barazimeve të dhëna. -Gjen barazinë e zgjidhjeve të inekuacioneve.	17.Paraqitja e të dhënave me diagram 18.leximi i të dhënave prej diagramit 19.Probabiliteti (Ngjarja) 20.Ushtrime 21.Të gjejmë faktorin e panjohur 22.Zbulojmë pjesëtuesin dhe të pjesëtueshmin e panjohur 23.Jobarazimet 24.Ushtrime 25.Perimetri i shumëkëndëshit 26.Perimetri i trekëndëshit 27.Perimetri i shumëkëndëshit (Drejtkëndëshit)		Diagrami i Venit		
				Bashkëbisedimi		

	<p>-Grumbullon dhe sistemon të dhënat në tabelat përkatëse.</p> <p>-Lexon dhe analizon të dhënat e grumbulluara.</p> <p>-Paraqet të dhënat në tabelë me diagram.</p> <p>-Komenton të dhënat e paraqitura në tabelë apo diagram, si dhe i krahason ato.</p> <p>-Parashikon mundësinë.</p> <p>-Bën provën, e mundur, e pamundur.</p>	<p>28.Perimetri i katrorit</p> <p>29. Ushtrime</p> <p>30.Njohuri fillestare per thyesat</p> <p>31.Thyesat që tregojnë të njëjtën pjesë të një tërësie</p> <p>32.Caktimi i pjesës së një tërësie</p> <p>33.Krahasimi i thyesave</p> <p>34. Ushtrime</p> <p>35.Vargjet numerike</p> <p>36. Ushtrime</p> <p>37.Matja e kohës (ora)</p> <p>38.Matja e kohës (ora, minuta)</p> <p>39.Matja e kohës (ora, ditët, java, muaji, viti)</p> <p>40. Ushtrime</p> <p>41. Identifikimi dhe dallimi i objekteve të ngjajshme me figurat dhe trupat gjeometrik</p> <p>42.Kubi</p> <p>43.Kuboidi (Kuadri)</p> <p>44.Vëllimi i trupave dhe njësia matëse</p> <p>45.Vëllimi i kubit dhe kuboidi</p> <p>46. Ushtrime</p>					
--	--	---	--	--	--	--	--

PLANIFIKIMI I ORËVE MËSIMORE

Matematika A

Tema: Numrat deri 100

Plankonspekt për mbajtjen e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Fusha kurrikulare: <u>Matematikë</u> / Lënda: <u>Matematikë</u> Shkalla e kurrikulës: <u>2</u> / Klasa: <u>3</u>
Tema: Numrat deri 100
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Njësia mësimore: Mbledhja dhe zbritja e numrave me kalim dhe prishje të 10
Fjalët kyçe: Mbledhje, zbritje
Format e punës: Frontale, individuale, në dyshe, grupe.
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: / Kriteret e suksesit: Nxënësi/ja: -Njehson zbritjen e numrave të dhënë / Njehso zbritjen e dy numrave të dhënë -Njehson mbledhjen e numrave të dhënë / Njehso mbledhjen e dy numrave të dhënë
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, tabela, shkumësi, fleta A4, fletorja dhe lapsi.
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuha shqipe, Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
Stuhi mendimesh-10min Mësimdhënësi me anë të pyetjeve i aktivizon nxënësit që të mbledhin dhe zbresin numrat duke i plotësuar rubrikat boshe (të zbrazëta) të dhëna në libër.
Të nxënëtit e përbashkët-20min Mësimdhënësi paraqet detyrën e dytë në tabelë ose përmes videoprojektorit dhe fton disa nxënës që bashkërisht t'i zgjidhin detyrat në tabelë. Kështu duke ua shpjeguar hap pas hapi ecurinë e punës.
Diskutin në grup-15min Mësimdhënësi i udhëzon nxënësit që në grupe të njehsojnë detyrat dhe përgjigjet e sakta t'i ngjyrosin sipas udhëzimeve.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Zgjedho nga tri detyra me mbledhje dhe zbritje sipas dëshirës.

Plankonspekt për mbajtjen e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Fusha kurrikulare: <u>Matematikë</u> / Lënda: <u>Matematikë</u> Shkalla e kurrikulës: <u>2</u> / Klasa: <u>3</u>
Tema: Numrat deri 100
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Njësia mësimore: Mbledhja e numrave dyshifrorë pa kalim të dhjetëshes
Fjalët kyçe: Mbledhje, numra dyshifrorë, pa kalim
Format e punës: Frontale, individuale, në dyshe, grupore.
Rezultati/et e të nxënimit të orës mësimore: / Kriteret e suksesit: Nxënësi/ja: -Mbledh numrat në boshtin numerik dhe plotëson drejtkëndëshin / Mbledh numrat në boshtin numerik dhe plotëso drejtkëndëshin -Plotëson klatrorët e zbrazët / Plotëso saktë klatrorët e zbrazët duke u bazuar në mbledhjen e numrave
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, tabela, shkumësi, fleta A4, fletorja dhe lapsi.
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuha shqipe, Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
Punë në çifte-10min Mësimdhënësi/ja pasi t'iu ketë dhënë sqarime rreth detyrës, udhëzon nxënësit që të punojnë në çifte për t'i nxjerrë rezultatet e kërkuara. Pasi ta kenë përfunduar detyrën nxënësit raportojnë para klasës për rezultatin e fituar.
DLTA-20min Pasi që mësimdhënësi/ja të ketë spjeguar mbarëvajtjen e detyrës, kërkon nga nxënësit/et që të plotësojnë në libër detyrën e caktuar dhe pastaj e përshkruajnë në fletore.
Punë e drejtuar-15min Udhëzon nxënësit që në mënyrën e drejtë të bëjnë zgjidhjen e duhur të detyrës.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Detyrën e fundit e plotësojnë në libër.

Plankonspekt për mbajtjen e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Fusha kurrikulare: <u>Matematikë</u> / Lënda: <u>Matematikë</u> Shkalla e kurrikulës: <u>2</u> / Klasa: <u>3</u>
Tema: Numrat deri 100
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Njësia mësimore: Mbledhja e numrave dyshifrorë me kalim të dhjetëshes
Fjalët kyçe: Mbledhja, numra dyshifrorë, me kalim
Format e punës: Frontale, individuale, në dyshe, grupore.
Rezultati/et e të nxënimit të orës mësimore: / Kriteret e suksesit: Nxënësi/ja: -Mbledh dhe plotëson rubrikat e zbrazëta / Mbledh dhe plotëso rubrikat e zbrazëta -Plotëson detyrën e tretë në mënyrë individuale / Plotëso detyrën e tretë në mënyrë individuale
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, tabela, shkumësi, fleta A4, fletorja dhe lapsi.
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuha shqipe, Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
Ecim me hapa-10min- Mësimdhësi/ja jep sqarimet e duhura për detyrën dhe kërkon nga nxënësit të zgjidhin detyrat hap pas hapi duke ndjekur udhëzimet e dhëna në libër. Mendo-krijo-diskuto-25min – Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që të zhvillojnë të menduarit e tyre lidhur me detyrën e dhënë dhe kërkon të krijojnë edhe nxënësit/et një detyrë të tillë. Në përfundim të detyrës kërkon që të diskutojnë rreth zgjidhjeve. Punë individuale-10min – Udhëzohen nxënësit që në mënyrë individuale të kryejnë zgjidhjen e detyrës së dhënë ndërkohë që puna e tyre përcillet nga mësimdhënësi/ja.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Detyrën e katërt e plotësojnë në libër.

Plankonspekt për mbajtjen e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë / Lënda: Matematikë Shkalla e kurrikulës: 2 / Klasa: 3

Tema: Numrat deri 100

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Detyra të ndryshme lidhur me mbledhjen dhe zbritjen

Fjalët kyçe: Detyra me mbledhje, zbritje

Format e punës: Frontale, individuale, në dyshe, grupore.

Rezultati/et e të nxënësve të orës mësimore: / Kriteret e suksesit:

Nxënësi/ja:

-Duke njehsuar ndihmon në gjetjen e lodrave / Duke njehsuar ndihmo për të gjetur lodrat

-Njehson shumën e numrave dyshifrorë / Njehso shumën e tre numrave dyshifrorë

-Zbulon dhe plotëson rregullën / Zbulon dhe plotëso rregullën

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, tabela, shkumësi, fleta A4, fletorja dhe lapsi.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuha shqipe, Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Gjej shokun/shoqen-10min –

Mësimdhënësi/ja paraqet para nxënësve aktivitetin e përgatitur më parë lidhur me gjetjen e një lodre dhe fton nxënësit në bazë të rezultateve të gjetura, të gjejnë lodrën e shokut apo shoqes.

Mblidh-grupo-plotëso-20min –

Nxënësit/et pasi t'i mbledhin detyrat bëjnë grupimin e tyre dhe rezultatet e fituara i plotësojnë në rubrikat specifike të dhëna në libër.

Punë e drejtuar-15min –

Udhëzohen nxënësit që në mënyrën e drejtë të bëjnë zgjidhjen e duhur të detyrës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit plotësojnë detyrën e pestë në libër.

Plankonspekt për mbajtjen e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Fusha kurrikulare: <u>Matematikë</u> / Lënda: <u>Matematikë</u> Shkalla e kurrikulës: <u>2</u> / Klasa: <u>3</u>
Tema: Numrat deri 100
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Njësia mësimore: Të gjejmë mbledhorin dhe zbritësin e panjohur
Fjalët kyçe: Mbledhor, zbritës, i panjohur
Format e punës: Frontale, individuale, në dyshe, grupore.
Rezultati/et e të nxëniet të orës mësimore: / Kriteret e suksesit: Nxënësi/ja: -Gjen vlerën e ndryshores X / Gjej vlerën e ndryshores X -Gjen në dy mënyra vlerën e ndryshores X / Gjej në dy mënyra vlerën e ndryshores X
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, tabela, shkurtesha, fleta A4, fletorja dhe lapsi.
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuha shqipe, Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
Lexim i drejtuar-10min – Mësimdhënësi/ja iu drejtohet nxënësve duke ua lexuar detyrën me anë të fjalëve dhe në bazë të asaj që nxënësit dëgjojnë gjejnë se çfarë do të mësojnë për këtë orë. Pastaj u jepen sqarimet e nevojshme lidhur me njësinë. Të nxënëtit e përbashkët-20min – Mësimdhënësi/ja nxjerr në tabelë disa nga nxënësit/et për të bërë zgjidhjen e detyrave bashkërisht. Duke iu dhënë sqarime u jepet mundësia për zgjidhje të detyrës ku ata do ta kenë më të lehtë kuptimin e tyre. Rrjeti i diskutimit-15min – Ndahen nxënësit në dy grupe dhe u ipen detyrat e veçanta. Më pas diskutojnë për rezultatet e fituara dhe kuptojnë zgjidhjen e duhur. Njëkohësisht realizohet vlerësimi i ndërsjellë.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Plotësojnë në libër detyrën e katërt.

Plankonspekt për mbajtjen e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë / Lënda: Matematikë Shkalla e kurrikulës: 2 / Klasa: 3

Tema: Numrat deri 100

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shumëzimi i numrave me 5 dhe me 10

Fjalët kyçe: Shumëzim i numrave

Format e punës: Frontale, individuale, në dyshe, grupore.

Rezultati/et e të nxënësve të orës mësimore: / Kriteret e suksesit:

Nxënësi/ja:

-Njehson prodhimin e numrave me anë të kartmonedhave / Njehso prodhimin e dy numrave me anë të kartmonedhave

-Zbaton prodhimin e numrave dhe bën mbledhjen në shtyllë / Zbato prodhimin e dy numrave

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, tabela, shkumësi, fleta A4, fletorja dhe lapsi.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Gjuha shqipe, Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Aktivitet-10min –

Për të qenë ora më atraktive për fëmijët, mësimdhënësi/ja e fillon orën me aktivitetin e përgatitur më parë. Jep udhëzimet e duhura dhe arrin qëllimin e saj.

Të nxënësve të orientuar-25min –

Mësimdhënësi/ja i orienton nxënësit/et në bazë të udhëzimeve të kryejnë veprimet e caktuara në detyrat e dhëna në libër. Detyrat zgjidhen në mënyrë grupore pastaj mësimdhënësi/ja përzgjedh një laps brenda grupit dhe kujt i përket lapsi ai/ajo përgjigjet për mënyrën se si e kanë zgjidhur detyrën.

Situatat problemore-10min – Nxënësit në mënyrë individuale zgjidhin problemet e dhëna në libër.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrën e fundit e plotësojnë në libër.

Plankonspekt për mbajtjen e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë / Lënda: Matematikë Shkalla e kurrikulës: 2 / Klasa: 3

Tema: Numrat deri 100

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shumëzimi i numrave me 2 dhe me 4

Fjalët kyçe: Shumëzimi i numrave

Format e punës: Frontale, individuale, në dyshe, grupore.

Rezultati/et e të nxënësve të orës mësimore: / Kriteret e suksesit:

Nxënësi/ja:

-Njehson prodhimin e numrave me anë të grumbullimit dhe grupimit të lapsave / Njehso prodhimin e dy numrave me anë të grumbullimit dhe grupimit të lapsave

-Zbulon rregullën dhe plotëson fushat me numrat e duhur / Zbulo rregullën dhe plotëso tri fushat e zbrazëta me numrat e duhur

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, tabela, shkumësi, fleta A4, fletorja dhe lapsi.

